

## KËRKESË PËR INFORMACION

<b>Emër Mbiemër<sup>1</sup>:</b> [Redacted]	<b>Adresa postare:</b> _____ <b>Adresa elektronike:</b> [Redacted] <b>Nr. Tel:</b> _____	<b>Data:</b> 30/9/2024 <b>Nënshkrimi:</b> [Redacted]
--	---	--

<b>Autoriteti Publik: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare</b>
<b>Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Kodi postar 1001</b>
<b>Qyteti: Tiranë</b>

### Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Rretit Ballkanik për Gazetari Investigative (BIRN), është angazhuar në një studim rajonal për çështjet e censurës dheurvejimit digjital në Ballkanin Perëndimor. Në kuadër të këtij studimi, kërkohen të dhënat e mëposhtme nga institucioni juaj:

1. A mund të shpjegoni procesin e ndjekur nga AKEP-it për identifikimin dhe bllokimin e përmbajtjeve online të konsideruara të paligjshme ose të dëmshme?
2. Si siguron AKEP gjatë këtij procesi respektimin e standardeve ndërkombëtare për lirinë e shprehjes kur zbaton rregulloret e përmbajtjes dixhitale?
3. Cila janë masat e marra për të siguruar transparencën e procesit në rastet kur AKEP kur vendos të bllokojë ose kufizojë aksesin në përmbajtjen online? A janë këto vendime/masa të disponueshme publikisht?
4. Çfarë mekanizmash ka AKEP për të garantuar përgjegjshmëri kur bëhet fjalë për heqjen e përmbajtjes apo bllokimin e faqeve të internetit?
5. A ka një proces apelimi për krijuesit e përmbajtjes ose pronarët e faqeve të internetit që mendojnë se përmbajtja e tyre është censuruar padrejtësisht? Nëse po, ju lutem vini në dispozicion informacion për këtë proces.
6. Si e vlerëson AKEP ndikimin e censurës dixhitale tek gazetarët, mediat e pavarura dhe organizatat e shoqërisë civile? A ka një procedurë të dedikuar për trajtimin përmbajtjes gazetareske, përmbajtjes me interes publik p.sh. materiale të publikuara nga aktivistë, media, organizata të shoqërisë civile etj.
7. Si garantohet nga AKEP respektimi i lirisë së shprehjes kur trajton rastet e mësipërme? Si trajtohen të dhënat personale gjatë këtyre proceseve?
8. A ka marrë AKEP ankime/reagime apo kritika nga aktorët e medias, organizata të shoqërisë civile, apo publiku në lidhje me rolin e tij në censurën dixhitale? Nëse po, cilat janë masat e marra për të adresuar këtë shqetësim?
9. A është institucioni juaj i përfshirë në ndonjë iniciativë (ligjore, strategjike, tjetër) që synon rishikimin ose përditësimin e qasjes aktuale rregullatore ndaj censurës dixhitale në Shqipëri? Nëse po, ju lutem vini në dispozicion informacion për këtë iniciativë.

<sup>1</sup> Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuarit.

10. Çfarë masash janë marrë nga AKEP për të adresuar sfidat e paraqitura nga teknologjitë e reja (p.sh., moderimi i përmbajtjes nëpërmjet Inteligjencës Artificiale) në kontekstin e censurës dixhitale?

11. Në kuadër të asistencës së ofruar nga AKEP për sektorë të ndryshëm, të përballur më sulme/incidente kibernetike, në sa raste është ofruar mbështetje e kësaj natyre për gazetarët, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile? Lutem përmendni aktorët përkatës.

### Të tjera të dhëna

---

---

**Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Format elektronik.**

---

### Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: \_\_/\_\_/2024

Numri rendor i kërkesës:

Komente: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar [e-albania.al](http://e-albania.al), [portalit pyetshtetin.al](http://portalit.pyetshtetin.al) apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit [pyetshtetin.al](http://pyetshtetin.al)
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.